



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË

Nr. 636 / 18 prot.

Tiranë më 29. 7. 2022

REKOMANDIM

Nr. 32, datë 29. 7. 2022

PËR KONTROLLUESIN “KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Kolegji i Posaçëm i Apelit”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 54, datë 01.04.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetim administrativ pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim, “Kontrolluesi dhe/ose “KPA”), me objekt:

- Verifikimi i procesit të përpunimit të të dhënave personale në kuadër të aksesit që ka Kontrolluesi në të gjitha databazat shtetërore veçanërisht në sistemin TIMS dhe zbatimi i detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një institucion kushtetues i pavarur që ka si qëllim Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë në shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelit është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b, Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 84 /2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, si dhe rregulloreve të tjera të miratuara.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave ndër të tjerë, “gjyqtarë”, “prokurorë”, “persona të lidhur”, “nëpunës”, “denoncues”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Nga verifikimi në vend, rezulton se Kontrolluesi ka akses të drejtpërdrejtë në tre regjistra databazash të cilat janë “Regjistri i hyrje daljeve në kufi” (në vijim, “Sistemi TIMS”), Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (në vijim, “RKGJC”) dhe Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore (në vijim, “RGJGJ”).

- Aksesi në RGJGJ të Ministrisë së Drejtësisë, kryhet për qëllim të verifikimit të “Aplikantëve” për punë dhe verifikimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve.
- Me shkresën nr. 887/1 prot., datë 08.01.2021, të Kontrolluesit drejtuar Ministrisë së Brendshme, është kërkuar akses i drejtpërdrejtë në RKGJC për 8 punonjës. Nga verifikimi, rezulton se aksesi i punonjësve, që kanë të drejta kërkimi dhe gjenerimi, konsistojnë në dokumente të tilla si:
 - ✓ certifikatë familjare;
 - ✓ certifikatë martese;
 - ✓ historiku i qendrave të votimit;
 - ✓ historiku i adresave të vendbanimit;
 - ✓ ndryshimet e emrit;
 - ✓ akt i lindjes;
 - ✓ akti i martesës; etj.
- Me shkresën nr. 886/1 prot., datë 23.12.2020, KPA i ka kërkuar Policisë së Shtetit, akses të drejtpërdrejtë në sistemin TIMS, duke krijuar llogari përdoruesish në modulën e kërkimit, konkretisht për 7 punonjës në pozicionin “këshilltarë të njësisë së shërbimit ligjor”. Nga verifikimi “on site”, rezulton se atributet e punonjësve konsistojnë në të drejta kërkimi dhe gjenerim dokumenti të tillë si:
 - ✓ informacion i përgjithshme në lidhje me qytetarin;
 - ✓ historiku i dokumenteve personale të qytetarit, si pasaporta dhe dokumente udhëtimi;
 - ✓ historiku i hyrje daljeve në kufi;
 - ✓ historiku i automjeteve të lidhura me qytetarin, etj.

Nga dokumentacioni i verifikuar, rezulton se deri në periudhën 23.12.2020, kanë pasur akses në dy regjistrat (sistemin TIMS dhe RKGJC), një numër i kufizuar punonjësish, konkretisht:

- pozicioni i parë i IT në sistemin TIMS;
- një specialisti i pritjes me popullin dhe një pozicion i parë i IT në RKGJC.

Sa më sipër, numri i punonjësve që kanë pasur akses në këto sisteme (përfshirë dhe në sistemin RGJGJ), ka qenë i kufizuar në 3 punonjës konkretisht, specialisti i pritjes me popullin, pozicioni i parë i IT dhe specialisti i burimeve njerëzore.

Aktualisht rezulton se numri i punonjësve të cilët kanë akses në këto sisteme, në total është 9 nëpunës (7 nëpunës kanë akses në sistemin TIMS dhe RKGJC, dhe 1 nëpunës ka akses në sistemin RGJGJ dhe në 1 në sistemin RKGJC) të autorizuar me Urdhër.

Nga verifikimi në vend, rezulton që punonjësit kanë akses kërkimi të pakufizuar në modulet e kërkimit në sistemet TIMS, RKGJC dhe RGJGJ por këto kërkime, nuk dokumentohen me procedura të brendshme. Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka një procedurë të rregulluar, me qëllim gjurmimin e çdo veprimi të punonjësve të autorizuar që kanë akses në të dhënat e këtyre regjistrave, në kundërshtim me parashikimet e neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përgjegjësia për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale qëndron për çdo institucion publik që ka akses në të dhënat në sistemet TIMS, RKGJC dhe RGJGJ dhe që administrojnë këto sisteme. Një nga masat kryesore për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit të të dhënave është edhe gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese dhe verifikimi i vazhdueshëm i saj, me qëllimin për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese është i rëndësishëm për t'i mundësuar KPA realizimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore për të garantuar konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale të cilat akseson me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore specifike. Kjo për të shmangur edhe pasojat e rënda që mund të vijnë në rast të aksesit ose përhapjes së paligjshme të të dhënave nga punonjësit e KPA, që kanë akses në të dhëna.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është e nevojshme që sisteme të tilla siç është TIMS, të garantojnë siguri në kuadër të autentifikimit dhe verifikimit sa më të saktë të personave që kanë akses, me qëllim që aksesit të mundësohet vetëm dhe ekskluzivisht për këta të fundit. Ndërkohë, duhet të bëhet e mundur që aksesit të ofrohet i kufizuar, në lidhje me rolin specifik të çdo përdoruesi dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave (germa "c" e pikës 1 të nenit 5 të Ligjit). Kjo nënkupton që të aksesohen vetëm ato kategori të dhënash dhe ato informacione që lidhen me qëllimin e përpunimit dhe legjislacionin specifik.

3. Kontrolluesi nuk ka publikuar "*politikat e privatësisë*", në faqen zyrtare www.kpa.al. Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë "*politikat e privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasojat e rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi CCTV, për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit, për qëllim të sigurisë së personelit dhe ambienteve por, konstatohet se Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010 të Komisionerit mbi *“Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Gjithashtu, Kontrolluesi, nuk ka rregullore dhe/ose politika të mirëfillta për sistemin e video-survejimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të ketë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezulton se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi disponon rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimin ,ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, por konstatohet se rregullorja nuk parashikon të gjitha proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me

ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47 , datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ, hartoi procesverbalin përkatës një kopje e të cilit e vendosi në dispozicion të Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 20.07.2022, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, përfaqësuesit e Kontrolluesit, kanë deklaruar se lidhur me disa prej shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ kanë marrë masat dhe janë duke punuar për rikuperimin e tyre, si dhe parashtruan këto pretendime:

- Sa i përket konstatimit në lidhje me *Njoftimin* pranë Zyrës së Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, Kontrolluesi ka paraqitur formularin e njoftimit të plotësuar manualisht më datë 02.06.2022;
- Sa i përket konstatimit për mbikëqyrjen nëpërmjet sistemit të video-survejjimit Kontrolluesi u shpreh se, tabelat informuese për prezencën e vidio-survejjimit (CCTV) janë vendosur në hyrje të godinës.
- Sa i përket konstatimit për publikimin e “*politikave të privatësisë*” në faqen zyrtare www.kpa.al, Kontrolluesi, ka marrë masat në përputhje me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, duhet të marrë masa për të garantuar aksesin e kufizuar dhe gjurmueshmërinë e veprimeve përpunuese në sistemet TIMS, RKGJC dhe RGJGJ për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale;

2. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, në mënyrë që përpunimi mos të jetë në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave për qëllimin dhe mënyrën e përpunimi të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masat për përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - i. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 2, 3 dhe 4 më sipër;
 - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
8. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisionerit vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 13. 7. 2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

